



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:047252

Datë: 06.07.2022

Numri i dokumentit: 03203852

P.nr.101/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve R. M. dhe F.Z. , që të dy nga Gjakova, për shkak të veprave penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.146/22 të datës 10.03.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **04.07.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit R. M. dhe F.Z. , të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R. M. nga Gjakovë, Rr” . . .** , i biri A. dhe i nënës F. e gjinisë L. , data e lindjes . . . në Gjakovë ,ka të kryer shkollën e mesme ,taxi ,e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i tre fëmije , ID . . .

I akuzuari **F.Z., nga Gjakova Rr” . . ”hyrja e tretë** , i biri B. dhe i nënës F. e gjinisë M. , data e lindjes . . . në Pejë ,ka të kryer shkollën e mesme ,i pa punë ,e gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i tre fëmijëve , ID . . .

I.

I pandehuri R. M. ;

Ë s h t ë f a j t o r :

Se:

-nga data e pavërtetuar e gjerë më dt.22.01.2022, rreth orës 19:00, në Gjakovë, në Rr. “. . .”, në lokalin pa mbishkrim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, pa pasur licencë apo leje nga organi kompetent, si dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), organizon dhe merr pjesë në zhvillimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një bastisje nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri është zënë në flagrancë duke ushtruar veprimtari me lojëra të fatit me aparate Apex, ku të pandehurit i sekuestrohen 4 aparate dhe 10€ si para të përfituara më vepër penale.

-me çka ka kryer veprën penale Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 4,17, 38,46,47,48,49,69,70, dhe nenit 294 par.2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton :

DËNIMIN ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj** ,i cili dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €**, si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë .

II.

I pandehuri F.Z.;

Ë s h t ë f a j t o r :

Se:

-me datë, kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe personin tjetër, pa pasur licencë apo leje nga organi kompetent, si dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), në cilësinë e menaxherit ndihmon në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një bastisje nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri është zënë në flagrancë duke ushtruar veprimtari me lojëra të fatit.

- me çka kanë ka kryer veprën penale Organizimi i Skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 4,17, 38,46,47,48,49,69,70, dhe nenit 294 par.2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton :

DËNIMIN ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj** ,i cili dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €**, si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë .

Gjykata në kuptim te dispozitës 115 të KPPRK-ës,

Konfiskohen të hollat si në vijim :

- 1.kartëmonedhë prej 10 euro , me nr.serik WA5268391462 (në shkresat e lëndës);
2. 4(katër) aparate Apex , pa numër serik të sekuestruara me datë 22.01.2022 nga st. Policor mnë Gjakovë .

Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuara në Prishtinë , që të ekzekuton këtë urdhëresë dhe të merr këto sende të si corpora delikti ,pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr146/22 të datës 10.03.2022, i ka akuzuar të akuzuarit R. M. dhe F.Z. , që të dy nga Gjakova, për shkak të veprave penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, duke propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.04.07.2022, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , lexoi aktakuzën PP/II.nr146/22 të datës 10.03.2022, dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari R. M. , lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer , por te njëjtin e kam kryer për shkak te gjendjes ekonomike me qe isha i pa punë dhe si familjar me është dashur te sigurojë te ardhura për familje ,pasi qe bashkëshortja është e diagnostikuar me kancer , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme , te me shqiptojë një dënim me te butë.

I akuzuari F.Z. , lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer gjegjësisht se kam punuar si punëtor , por te njëjtin e kam kryer për shkak te gjendjes ekonomike me qe isha i pa punë dhe si familjar me është dashur te sigurojë te ardhura për familje ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm , faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit Prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve pasi qe pranimi i fajësisë është bërë ne mënyrë vullnetare e duke i kuptuar me parë pasojat dhe benefitet e pranimi te fajësisë ,te sqaruara edhe nga ana e gjykatës e po ashtu ky pranimi i fajësisë gjen mbështetje te plote edhe ne provat te cilat e mbështesin aktakuzën ,pra me vet pranimin e fajësisë është vërtetuar ne tërësi gjendja faktike e përshkruar si ne dispozitivat e aktakuzës , andaj gjykatës i propozoi qe pranimin e fajësisë si shprehje e lirë e vullnetit ta pranojë dhe te akuzuarve te ju shqiptojë nga një dënim meritor komform ligjit , njëherë te obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale ,e po ashtu konform nenit 115 të KPPK-ës propozoi qe te konfiskohen sendet e përdorura dhe te fituara me kryerjen e veprës penale siç janë specifikuar në piken III si ne aktakuzë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit R. M. :**I. -nga data e pavërtetuar e gjerë më dt.22.01.2022, rreth orës 19:00, në Gjakovë, në Rr. “. . .”, në lokalin pa mbishkrim**, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, pa pasur licencë apo leje nga organi kompetent, si dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), organizon dhe merr pjesë në zhvillimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, në atë mënyrë

që ditën kritike pas një bastisje nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri është zënë në flagrancë duke ushtruar veprimtari me lojëra të fatit me aparate Apex, ku të pandehurit i sekuestrohen 4 aparate dhe 10€ si para të përfituara më vepër penale, ndërsa i akuzuari F.Z. :**II. -me datë, kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit**, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe personin tjetër, pa pasur licencë apo leje nga organi kompetent, si dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (Ligji nr.06/L-155), në cilësinë e menaxherit ndihmon në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një bastisje nga ana e zyrtarëve policor, i pandehuri është zënë në flagrancë duke ushtruar veprimtari me lojëra të fatit.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësin penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve , gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethanë rënduese gjykata konsideron faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale si në dispozitivat e aktakuzës ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve se të njëjtit janë prindër, njerëz familjar , sjelljen e korrekte në gjykatë. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tyre që të gjykata janë kuptuar si njerëz të sjellshëm. korrekt dhe të vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, janë penduar thellë për veprën penale të kryer Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në çdo fazë të procedurës ,shprehjen e keqardhjes për veprën e kryer , premtimi se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme ,gjendjen e tyre të dobët ekonomike, mbajtës të vetëm të familjes , të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatojë dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 70 të KPRK-së, gjykata të akuzuarve iu shqipton dënim me burg prej nga 8 (tetë) muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e sendeve të përdorura për kryerjen e veprës penale është marr konform nenit 115 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale për të akuzuarit dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 20.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën

par. 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € ,është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimet .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.104/22 më datë 04.07.2022

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.